

Fjala përmbyllëse e Enkeleda Shehi: Konferenca e pensioneve private

Do doja të falënderoja të gjithë ata që morën pjesë në konferencën e sotme. Kjo është një ngjarje shumë e vlefshme për AMF-në – dhe shpresoj për të gjithë në këtë sallë - pasi ne kërkojmë të zhvillojmë sistemin e pensioneve private në Shqipëri.

Do doja të përmbledhja disa nga mesazhet kryesore të aktivitetit të sotëm, të cilat do të jenë pjesë e fazës së ardhshme së strategjisë së AMF-së lidhur me zgjerimin e mbulimit të pensioneve.

Folëm për rëndësinë e përfundimit të procesit të ndryshimeve fiskale me qëllim që kursimet në pensionet private të trajtohen në mënyrë të favorshme, e jo të penalizohen, për të gjithë në Shqipëri – duke vijuar më tej me ndryshimet e rëndësishme të bëra deri më tani.

Dëgjuam për rolin e rëndësishëm të punëdhënësit – dhe se si punëdhënësit në Shqipëri po korrin të mirat e sigurimit të një përfitimi kaq të rëndësishëm për punonjësit e tyre. Shpesh, ndërtimi i mirëkuptimit është një rrugë e gjatë – por ky është një udhëtim që ja vlen të ndërmerret për të mirën e një fuqie punëtore më të angazhuar në të tashmen dhe pensione më të mira në të ardhmen – dhe kjo është diçka që të gjithë kemi interes të mbështesim.

Rezultatet nga vrojtimi i parë i INSTAT lidhur me qëndrimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve, nxorën qartë disa sfida kritike, në ofrimin e informacionit të thjeshtë për të ndihmuar punëmarrësit dhe punëdhënësit të kuptojnë përse pensionet janë të rëndësishme dhe si mund të sjellin përfitime reale. Ky studim na jep informacion të rëndësishëm në bazë të të cilit AMF mund të masë suksesin e strategjisë së saj të zgjerimit të mbulimit, dhe ne duhet të përdorim rregullisht anketat si një mjet për të treguar progresin tonë. Gjithashtu, ky studim identifikon fushat që kërkojnë studime të mëtejshme, si për shembull si të përballohen shpenzimet e kontributeve të pensionit.

Shoqëritë e pensioneve kanë rolin kryesor të përkthimit të kontributeve në të ardhurat e marra gjatë daljes në pension. Ata kanë përcaktuar disa nga sfidat dhe sukseset deri më tani. Ata dëgjuan për potencialin për rritje të konsiderueshme nëse promovojnë në mënyrë aktive dhe

ofrojnë me efikasitet produkte të cilat kanë një raport të mirë të çmimit më cilësinë, si dhe ndihmojnë njerëzit e zakonshëm të kenë akses në përfitimet e investimeve afatgjata.

Do doja të falënderoja Z. Dan Pescaru nga autoriteti homolog i Rumanisë dhe Znj. Tahseen Sayed nga Banka Botërore për ndihmën e dhënë në sjelljen e diskutimeve tona në dimension ndërkombëtar, në mënyrë që ne mund të ndërtojmë në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, duke u përshtatur me kontekstin shqiptar.

Për të përfunduar, do doja të thoja se kjo konferencë është fillimi dhe jo fundi i udhëtimit. Për AMF-në është thelbësore të ketë një forum ku të dëgjohen pikëpamjet tuaja dhe ku të fillojnë bisedimet se si të ofrojmë një sistem të fortë të pensioneve për Shqipërinë – duke ndërtuar mbi reformën për pensionet publike, për të cilën foli Ministri Klosi – dhe të zhvillojmë pensionet private në mënyrë që të kemi një sistem të larmishëm që mund të na pajisi më mirë për sfidat që do të vijnë.